



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2019:282723

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514892

**P.nr.82/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e çështjes Laura Hoti Statovci me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, duke vendosur lidhur me pranimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me numër Nd.684/23 të datës 22.11.2023, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.5736/19 e datës 03.12.2019, kundër të akuzuarve E. R. E. R. dhe M. R. të gjithë për veprën penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së, jashtë seancës konform nenit 229 të KPPRK-së, dhe nenit 2 lidhur me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (tutje: Ligji për Ndërmjetësim), Gjykata më datën 27.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I.** APROVOHET marrëveshja nr. Nd.684/23 të datës 22.11.2023, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të akuzuarit E.R., E. R. dhe M. R. në një të ane dhe të akuzuarit V. B. në anën tjetër.
- II.** HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.5736/19 e datës 03.12.2019 dhe,
- III.** PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarve E. R., E. R. dhe M. R. për shkak të veprës penale Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së për shkak se të akuzuarit dhe i dëmtuari kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën PP.II.nr.5736/19 e datës 03.12.2019, ka ngritur aktakuzë kundër të akuzuarve E. R., E. R. dhe M. R. Lëndim i lehte trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata me datë 15.11.2023 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale dhe me akordimin e palëve në procedurë e duke vepruar konform nenit 8 dhe 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendrën për Ndërmjetësim.

Me datë 14.02.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.684/23 të datës 22.11.2023 në mes të palëve në procedurë. Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Konform nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësimin, nga data e pranimit nga gjykata, përkatësisht nga data 14.02.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të KPPRK-së lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.82/20 më datë 27.03.2024

**Bashkëpunëtori profesional**  
Albrim Kastrati

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Laura Hoti Statovci**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa dhe e njëjta do ta ketë Fuqinë e titullit ekzekutiv.